

| Emri i Lëndës : Sisteme të Informimit dhe Komunikimit |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                     |                     |                |         |      |
|-------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|---------------------|----------------|---------|------|
| Kodi                                                  | Tipi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Semestri                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | Leksione (orë/javë) | Seminare (orë/javë) | Lab (orë/javë) | Kredite | ECTS |
| MUL 203                                               | A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Vjeshtë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | 3.00                | 0.00                | 3.00           | 3.00    | 6.00 |
|                                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                     |                     |                |         |      |
| Lektori                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Grasiela Baçellari, Msc                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                     |                     |                |         |      |
| Asistenti                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                     |                     |                |         |      |
| Gjuha e kursit                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Shqip                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                     |                     |                |         |      |
| Niveli i lëndës                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Program Profesional 2-Vjeçar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                     |                     |                |         |      |
| Përshkrimi                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Lënda synon të zhvillojë te studentët kuptimin mbi bazat teknologjike të sistemeve të informacionit dhe komunikimit, duke integruar konceptet e teknologjisë së informacionit (IT) me aplikimet në multimedia dhe dizajn grafik. Studentët do të mësojnë të kuptojnë se si funksionon infrastruktura digjitale nga hardueri dhe rrjetet, tek bazat e të dhënave, cloud computing dhe inteligjenca artificiale dhe si këto teknologji përdoren për krijimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e përmbajtjeve vizuale e multimediale.     |                     |                     |                |         |      |
| Objektivat                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Në përfundim të kursit, studenti do të jetë në gjendje të: - Shpjegojë strukturën e sistemeve të informacionit dhe rolin e tyre në teknologjinë moderne; - Kuptojë arkitekturën e rrjeteve dhe komunikimit digjital; - Aplikojë konceptet e ruajtjes së të dhënave dhe cloud computing në menaxhimin e përmbajtjeve multimediale; - Kuptojë ndikimin e sigurisë, etikës dhe privatisë në përpunimin e të dhënave; - Analizojë rolin e inteligjencës artificiale dhe automatizimit në proceset krijuese dhe komunikimin digjital. |                     |                     |                |         |      |
| Konceptet Kryesore                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Hardware, Software, Sistemet e Informacionit, Arkitektura e rrjeteve, Cloud Computing, Bazat e të Dhënave, Komunikimi Digjital, Siguria e të Dhënave, Multimedia, AI.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                     |                     |                |         |      |
| Programi i Lëndës                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                     |                     |                |         |      |
| Java                                                  | Tema                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                     |                     |                |         |      |
| 1                                                     | Prezantimi i kursit dhe programit mësimor.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                     |                     |                |         |      |
| 2                                                     | Hyrje në Sistemet e Informimit dhe Komunikimit. Kjo temë ofron një hyrje të zgjeruar në konceptin e Sistemeve të Informimit dhe Komunikimit (SIK), duke shpjeguar përbërësit dhe funksionet e tyre kryesore. Studentët mësojnë si informacioni krijohet, përpunohet, ruhet dhe shpërndahet përmes sistemeve digjitale, me fokus në përmbajtjet vizuale dhe multimediale. Diskutohet roli i SIK në industri kreative, media digjitale, marketing dhe dizajn grafik, si dhe ndikimi i tyre në transformimin e komunikimit modern. |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                     |                     |                |         |      |
| 3                                                     | Arkitektura e një sistemi informacioni. Në këtë temë analizohet arkitektura e një sistemi informacioni, duke identifikuar komponentët kryesorë: hardware, software, rrjetet, të dhënat dhe përdoruesit. Studentët kuptojnë mënyrën se si këta elementë bashkëveprojnë për të ndërtuar sisteme funksionale dhe të besueshme.                                                                                                                                                                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                     |                     |                |         |      |
| 4                                                     | Komponentët fizikë të një sistemi. Kjo javë fokusohet në komponentët fizikë të sistemeve kompjuterike, duke përfshirë CPU, RAM, pajisjet e ruajtjes dhe pajisjet hyrje/dalje. Studentët kuptojnë se si performanca e hardware-it ndikon drejtpërdrejt në përpunimin e imazheve, videove dhe aplikacioneve grafike. Diskutohet rëndësia e zgjedhjes së pajisjeve të përshtatshme për punë kreative dhe multimediale.                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                     |                     |                |         |      |
| 5                                                     | Sistemet operative moderne. Në këtë temë trajtohen sistemet operative moderne si Windows, macOS dhe Linux, duke analizuar funksionet e tyre kryesore dhe ndërveprimin me përdoruesin. Studentët mësojnë se si sistemet operative krijojnë mjedisin e punës për aplikacione multimediale dhe grafike. Theksi vihet në menaxhimin e skedarëve, burimeve dhe pajtueshmërinë me softuerë kreativë.                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                     |                     |                |         |      |

|                                                                                                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>6</b>                                                                                                                            | Bazat e rrjeteve kompjuterike. Kjo javë prezanton konceptet bazë të rrjeteve kompjuterike, përfshirë llojet e rrjeteve, protokollet e komunikimit, adresimin IP dhe DNS. Studentët kuptojnë se si rrjetet mundësojnë shpërndarjen e përmbajtjes multimediale dhe bashkëpunimin online.       |
| <b>7</b>                                                                                                                            | Përsëritje dhe prezantim projekti (Faza I)                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>8</b>                                                                                                                            | Provimi Gjysmëfinal                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <b>9</b>                                                                                                                            | Komunikimi digjital dhe rrjetet sociale. Kjo temë analizon komunikimin digjital dhe rolin e rrjeteve sociale në shpërndarjen e informacionit vizual. Studentët mësojnë se si përmbajtjet multimediale perceptohen nga audienca dhe si ndikojnë platformat digjitale në dizajn dhe komunikim. |
| <b>10</b>                                                                                                                           | Bazat e të dhënave. Në këtë javë trajtohen konceptet bazë të databazave, organizimi i të dhënave, roli i metadata-s dhe ruajtja e mediave digjitale. Studentët kuptojnë rëndësinë e databazave në menaxhimin e projekteve multimediale dhe platformave kreative.                             |
| <b>11</b>                                                                                                                           | Cloud Computing. Kjo temë shpjegon konceptin e cloud computing dhe përdorimin e tij në ruajtjen, menaxhimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve multimediale. Diskutohet bashkëpunimi online, aksesueshmëria dhe siguria e të dhënave në cloud.                                                  |
| <b>12</b>                                                                                                                           | Inteligjenca artificiale. Në këtë javë analizohet roli i inteligjencës artificiale në multimedia dhe dizajn grafik. Studentët njihen me aplikimet e AI në përpunimin e imazheve, videove dhe automatizimin e proceseve kreative.                                                             |
| <b>13</b>                                                                                                                           | Prezantimi efektiv i informacionit dhe Transformimi digjital. Kjo temë kombinon parimet e prezantimit efektiv të informacionit me konceptin e transformimit digjital. Studentët mësojnë se si teknologjitë moderne ndryshojnë mënyrën e komunikimit vizual dhe prezantimit të ideve.         |
| <b>14</b>                                                                                                                           | Prezantim Projekti (Faza II)                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>15</b>                                                                                                                           | Përsëritje para provimit final                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>16</b>                                                                                                                           | Provimi Final                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Parakushtet</b> Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>Literatura</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• INTRODUCTION TO COMPUTER - Fred Mugivane</li> <li>• CompTIA .</li> </ul> |                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>Referenca të tjera</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Video tutoriale, cikel leksionesh.</li> </ul>                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat</b>                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>1</b>                                                                                                                            | Aftësi për përdorimin funksional të teknologjive digjitale dhe platformave cloud në projekte multimediale.                                                                                                                                                                                   |
| <b>2</b>                                                                                                                            | Aftësi për organizimin dhe menaxhimin e të dhënave dhe përmbajtjeve vizuale.                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>3</b>                                                                                                                            | Zhvillim i mendimit kritik dhe ndërgjegjësimi për përdorimin etik dhe të sigurt të teknologjive moderne.                                                                                                                                                                                     |

| <b>Mënyra e Vlerësimit të Lëndës</b>                                                     |              |                          |                              |
|------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|--------------------------|------------------------------|
| <b>Notat e Ndërmjetme</b>                                                                | <b>Sasia</b> | <b>Përqindja</b>         |                              |
| Gjysmë finale                                                                            | 1            | 20                       |                              |
| Kuize                                                                                    | 0            | 0                        |                              |
| Projekte                                                                                 | 1            | 30                       |                              |
| Projekte semestrale                                                                      | 0            | 0                        |                              |
| Punë laborator                                                                           | 0            | 0                        |                              |
| Pjesëmarrja në mësim                                                                     | 1            | 10                       |                              |
| <b>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</b>                            |              |                          | <b>60</b>                    |
| <b>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</b>                                  |              |                          | <b>40</b>                    |
| <b>Total</b>                                                                             |              |                          | <b>100</b>                   |
| <b>Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)</b>                                 |              |                          |                              |
| <b>Aktivitetet</b>                                                                       | <b>Sasia</b> | <b>Kohëzgjatja (orë)</b> | <b>Ngarkesa Totale (orë)</b> |
| Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit) | 16           | 6                        | 96                           |
| Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)                              | 14           | 2                        | 28                           |
| Detyra                                                                                   | 1            | 6                        | 6                            |
| Gjysmë finale                                                                            | 1            | 8                        | 8                            |
| Provimi final                                                                            | 1            | 12                       | 12                           |
| Të tjera                                                                                 | 0            | 0                        | 0                            |
| <b>Ngarkesa totale e orëve</b>                                                           |              |                          | <b>150</b>                   |
| <b>Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)</b>                                                |              |                          | <b>6.00</b>                  |
| <b>ECTS</b>                                                                              |              |                          | <b>6.00</b>                  |